



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr.07- 60/01-17890/19

Kaçanik, 28.06.2019

RREGULLLORE NR. 01/2019

PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

Qershor 2019

Duke marrë parasysh përgjegjësinë e secilit ndaj mjedisit jetësor, të përcaktuar në nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke vepruar sipas nenit 12.2(c), 17(f), dhe 40.2(a) Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 13 pika 1, 2 lidhur me nenin 15 të Ligjit Nr. 04/L-060- Për Mbeturina (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2012), të nenit 6.2 lidhur me nenin 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28 Qershor 2019, miratoj këtë:

RREGULLLORE NR. 01/2019 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1.1 Kjo rregullore ka për qëllim të vendosë një sistem të qëndrueshëm të menaxhimit të integruar të mbeturinave dhe të ndihmoj në ruajtjen e mjedisit. Menaxhimi i integruar përfshinë përpjekjet për t'i parandaluar dhe zvogëluar mbeturinat e deponuara.
- 1.2 Kjo rregullore përcakton:
 - (A) kushtet dhe mënyrën e menaxhimit të mbeturinave;
 - (B) të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve dhe
 - (C) tarifatat për shërbimin.
- 1.3 Kjo rregullore nuk zbatohet për:
 - (A) mbeturinat e rrezikshme dhe
 - (B) llumin, baltën dhe mbeturinat e ngjashme.

Neni 2

Përkufizimet

- 2.1 **Mbeturinë** - Lëndë ose objekt që gjeneruesi ose zotëruesi e hedhë, ka për qëllim ta hedhë ose detyrohet ta hedhë.
- 2.2 **Gjenerues** - Prodhuesi ose personi që gjeneron mbeturinën. Prodhues është çdo person që me veprimtarinë e vet gjeneron mbeturinë ose ia ndryshon natyrën ose përbërjen mbeturinës.
- 2.3 **Menaxhim i mbeturinave** - Menaxhim i integruar i mbeturinave. Menaxhim i integruar janë veprimtaritë për të menaxhuar mbeturinat dhe për të parandaluar dhe zvogëluar prodhimin dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Veprimtaritë përfshijnë ripërdorimin, kompostimin, ndarjen sipas llojit, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, mbledhjen, bartjen, trajtimin, përpunimin, riciklimin, deponimin përfundimtar të mbeturinave si dhe vëzhgimin dhe kujdesin e vazhdueshëm pas deponimit.

- 2.4 **Operator** - Person i licencuar nga MMPH-ja për të ofruar shërbime të menaxhimit të mbeturinave.
- 2.5 **Mbledhje e mbeturinave** - Mbledhje dhe bartje e mbeturinave, të ndara sipas llojit dhe grumbullim e mbeturinave me qëllim për t'i bartur deri te objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 2.6 **Pikë grumbulluese** - Lokacion ku vendosen shportat, kontejnerët dhe qeset e thasët për grumbullimin e mbeturinave.
- 2.7 **Qendër grumbulluese** - Lokacion për pranimin ose grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve që i përcakton qendra.
- 2.8 **Shërbim** - Çdo shërbim në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Shërbimi përfshin mbledhjen, grumbullimin, bartjen dhe trajtimin e mbeturinave.
- 2.9 **Kompostim** - Trajtim i mbeturinave bio nën veprimin e mikroorganizmave në praninë e oksigjenit, me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushtet e kontrolluara.
- 2.10 **Ligji për Mbeturina** - Ligji nr. 03/L-040, për mbeturina, GZRK 17/2012.
- 2.11 **MMPH** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- 2.12 **GZRK** - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Llojet dhe klasifikimi i mbeturinave

- 3.1 Lloji dhe klasifikimi i mbeturinave përcaktohet sipas:
- (A) Ligjit për Mbeturina, nenet 6 dhe 7;
 - (B) Udhëzimit Administrativ të MMPH-së, nr. 13/2013, për katalogun shtetëror të mbeturinave, botuar në GZRK më 6 nëntor 2014; dhe
 - (C) akteve tjera nënligjore.
- 3.2 **Mbeturina Komunale** - Mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga veprimtaritë tjera që për nga natyra dhe përbërja janë të ngjashme me mbeturinat nga amvisëritë.
- 3.3 **Mbeturina Komerciale** - Mbeturinat që vijnë nga objektet që përdoren për qëllime të biznesit, sportit, edukimit ose rekreacionit, por nuk përfshijnë mbeturinat industriale.
- 3.4 **Mbeturinat Industriale** - Mbeturinat nga ecuritë industriale, prodhimtaritë artizanale dhe veprimtaritë e tjera prodhuese. Prodhuesit janë përgjegjës për menaxhimin e tyre sipas Ligjit për mbeturina, neni 18 dhe akteve nënligjore.
- 3.5 **Mbeturina Mjekësore** - Mbeturinat nga veprimtaria dhe produktet mjekësore. Ato mund të bartin sëmundje. Përfshijnë mbeturinat medicinale, humane dhe veterinare. Menaxhohen sipas:
- (A) Udhëzimit Administrativ të MMPH-së, nr. 22/2013, për menaxhimin e mbeturinave medicinale, humane dhe veterinare, botuar në GZRK më 6 nëntor 2014; dhe

- (B) Udhëzimit Administrativ të MMPH-së, nr. 10/2015, për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale, botuar në GZRK më 18 shtator 2015.
- 3.6 **Mbeturinat e Rrezikshme** - Mbeturinat që kanë tiparet e përcaktuara me Ligjin për mbeturina, Shtojca III, Lista H. Mund të përfshijnë mbeturinat industriale dhe mjekësore.
- 3.7 **Mbeturina të Parrezikshme** - Mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk kanë tipare të mbeturinave të rrezikshme.
- 3.8 **Mbeturina Inerte** - Mbeturinat që nuk pësojnë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik ose biologjik aty ku deponohen. Ato nuk treten, nuk ndizen dhe nuk reagojnë fizikisht ose kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me lëndët e tjera dhe nuk ndikojnë ndjeshëm në mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Kullimi, përmbajtja ndotëse dhe mbetjet ekotoksike të mbeturinave inerte janë të vlerës së papërfillshme dhe nuk rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore.
- 3.9 **Mbeturina të Ndërtim - rrënim** - Mbeturinat nga veprimtaria ndërtimore dhe nga meremetimi dhe rrënimi i objekteve. Ato menaxhohen sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 07/2015, për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, botuar në GZRK më 27 korrik 2015.
- 3.10 **Mbeturina të Vëllimshme** - Mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë. Ato largohen, grumbullohen dhe barten në mënyrë të veçantë.
- 3.11 **Mbeturinat bio** - Mbeturina të biodegradueshme nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga amvisëritë, restorantet, hotelieritë, shitoret si dhe mbeturinat e ngjashme nga industria ushqimore. Mund të trajtohen me kompostim. Nuk përfshijnë mbeturinat shtazore. Menaxhohet sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 20/2014, për menaxhimin e mbeturinave biodegraduese, botuar në GZRK më 6 nëntor 2014.
- 3.12 **Mbeturinat Shtazore** - Mbeturinat dhe mbetjet e kafshëve që krijohen nga amvisëritë, mishtoret, thertoret dhe veprimtaritë e ngjashme.

Neni 4 **Përgjegjësitë e Komunës**

- 4.1 Komuna ka për detyrë të menaxhon këto mbeturina:
- (A) mbeturinat komunale;
 - (B) mbeturinat komerciale;
 - (C) mbeturinat inerte;
 - (D) mbeturinat e vëllimshme;
 - (E) mbeturinat e ndërtim-rrënim dhe
 - (F) mbeturinat bio.
- 4.2 Komuna mbikëqyrë dhe inspekton zbatimin e Ligjit për Mbeturina dhe akteve nënligjore në lidhje me:

- (A) mbeturinat industriale dhe
 - (B) mbeturinat mjekësore.
- 4.3 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përcakton vende të duhura të kontejnerëve për barna të skaduar, sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 22/2013, për menaxhimin e mbeturinave medicinale, humane dhe veterinare, botuar në GZRK më 6 nëntor 2014, neni 7.5.
- 4.4 Komuna menaxhon deponinë e mbeturinave inerte sipas:
- (A) Kuvendi Komunal e cakton lokacionin e deponisë së mbeturinave inerte dhe Komuna e menaxhon deponinë sipas Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nr. 03/L-214, GZRK 83/2010;
 - (B) Udhëzimit administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 08/2017, për menaxhimin e deponive të mbeturinave, botuar në GZRK më 29 gusht 2017; dhe
 - (C) Udhëzimit administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nr. 07/2015, për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, botuar në GZRK më 27 korrik 2015.

Neni 5

Spektori për Menaxhimin e Mbeturinave

- 5.1 Spektori për Menaxhimin e Mbeturinave, që do të veproj në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave të Komunes.
- 5.2 Spektori ka për detyrë:
- (A) të hartoj dhe të zbatoj planin komunal për menaxhimin e mbeturinave në përputhje me planin nacional;
 - (B) të caktoj vendndodhjen e pikave të grumbullimit;
 - (C) të caktoj, me pëlqimin e Kuvendit Komunal, lokacionin për qendrën grumbulluese për:
 - (1) mbeturinat e vëllimshme;
 - (2) mbeturinat e ndërtim-rrënimin dhe
 - (3) mbeturinat elektrike dhe elektronike;
 - (D) të përcaktoj llojin e shportave dhe kontejnerëve në përputhje me teknikën me të cilën mbledhen, ndahen dhe barten mbeturinat;
 - (E) të caktoj orarin e mbledhjes së mbeturinave në marrëveshje me operatorin dhe sipas nevojës, ta autorizoj operatorin që të mbledhë mbeturinat edhe jashtë orarit të rregullt;
 - (F) të identifikoj dhe të mënjanë pikat ilegale të mbeturinave;
 - (G) të mbikqyrë operatorët dhe t'ua siguroj kushtet e veprimin;

- (H) të nxis zvogëlimin e mbeturinave përmes konceptit 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim);
- (I) të njoftoj publikun për menaxhimin e mbeturinave;
- (J) të shqyrtoj ankesat e klientëve sa u përket shërbimeve dhe
- (K) të përpiloj raportet për menaxhimin e mbeturinave, përfshirë raportin vjetor që i dorëzohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor brenda 31 marsit.

Neni 6

Operatorët

- 6.1 Organi kontraktues i Komunës përzgjedh operatorët për të ofruar shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.
- 6.2 Komuna mund të përzgjedhë për operator një ndërmarrje në pronësi të Komunës pa ndjekë procedurat e tenderimit sipas legjislacionit për prokurimin publik.
- 6.3 Operatorët duhet të veprojnë sipas kontratës dhe dispozitave ligjore.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve

- 7.1 Çdo gjenerues ka të drejtën e qasjes në shërbim. Ai ka të drejtë të parashtroj ankesë lidhur me shërbimin.
- 7.2 Gjeneruesit kanë për detyrë:
 - (A) të bashkëpunojnë me autoritetet publike për të siguruar një mjedis të pastër;
 - (B) t'i ndajnë mbeturinat sipas llojit;
 - (C) t'i hedhin ose dorëzojnë mbeturinat e një lloji:
 - (1) në shporta dhe kontejnerë të përcaktuar për atë lloj;
 - (2) në pika ose qendra grumbulluese të përcaktuara për atë lloj ose
 - (3) te operatori;
 - (D) të respektojnë rregullat e shkarkimit, të përcaktuara sipas planin të menaxhimit;
 - (E) të përpiqen me zvogëluar sasinë e mbeturinave përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme;
 - (F) ta njoftojnë Sektorin kur gjenerojnë mbeturina të ndërtim-rrënimit;
 - (G) të regjistrojnë amvisërinë dhe veprimtarinë e vet dhe të njoftoj ndryshimin e të dhënave lidhur me pronësinë, përfshirë rastet e shitblerjes, trashëgimisë dhe bartjes në mënyrë tjetër; dhe
 - (H) të paguajnë tarifat e shërbimit.
- 7.3 Komuna regjistron amvisëritë dhe veprimtaritë sipas këtyre dokumenteve:
 - (A) kontrata e shitblerjes;

- (B) regjistrimi i njehsorit të energjisë elektrike;
 - (C) dëftesa e pagesës për mbeturinat në vendbanimin ose lokalin paraprak dhe
 - (D) dokumenti i identifikimit.
- 7.4 Në rast të shitblerjes së amvisërisë ose veprimtarisë, Komuna regjistron blerësin nëse nuk ka qenë i regjistruar, kurse shitësin e regjistron me adresën e re.
- 7.5 Veprimtaritë prodhuese kanë për detyrë t'i dorëzojnë Komunës planin e menaxhimit të mbeturinave që gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 8

Kategoritë e gjeneruesve

8.1 Gjeneruesit ndahet në këto kategori:

- (A) **A** — kategoria e amvisërive, të ndara në nënkategori:
 - (1) **A-1** — nënkategoria e parë, përfshin klientët e shërbyer derë më derë, në vendbanime urbane dhe rurale; dhe
 - (2) **A-2** — nënkategoria e dytë, përfshin klientët e shërbyer me kontejnerë të përbashkët, në vendbanime urbane dhe rurale;
- (B) **K** — kategoria e klientëve komercialë e industrialë, të ndarë në nënkategori:
 - (1) **K-1** — nënkategoria e parë, përfshin veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese, si për shembull:
 - (a) Kioskat, shitoret dhe dyqanet e madhësisë së ngjashme me të kioskave;
 - (b) shitoret e dyqanet e vogla, siç janë shitësit e kafes, disqeve, kozmetikës, syzeve e thjerrëzave dhe suvenirëve; argjendaritë, orëtarët, agjencitë turistike, rrobaqepësit, këpucëtarët, fotografët, butikët, libraritë, dyqanet e pastrimit kimik, gurgdhendësit, saraçmbathtarët, këmbimoret, llamarinë-punuesit dhe axhustatorët;
 - (c) zyrat e shërbimeve profesionale me madhësi deri në 20 m², siç janë zyrat e vogla të avokatëve, noterëve, përmbaruesve, këshilltarëve financiarë dhe organizatave joqeveritare;
 - (d) veprimtari tjera të vogla, siç janë parkingjet, qendrat e videolojërave dhe kurset e gjuhëve dhe teknologjisë; dhe
 - (e) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë; dhe
 - (2) **K-2** — nënkategoria e dytë, përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të ulët të shërbimit, si për shembull:
 - (a) lokalet për shitjen dhe mirëmbajtjen e automjeteve, duke përjashtuar auto ngjyrosësit;
 - (b) frizerët dhe lokalet e tjera të kujdesit personal;

- (c) barnatoret, klinikat e vogla dhe ambulancat stomatologjike me deri në dy karrige;
 - (d) serviset e pajisjeve teknike dhe elektronike;
 - (e) shitoret e vogla, përfshirë shitoret sanitare, të mobilieve, autopjesëve, tekstilit dhe këpucëve; dhe
 - (f) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe lokale me mbi 20 m²;
- (3) **K-3** — nënkategoria e tretë, përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të moderuar të shërbimit, si për shembull:
- (a) furrat e bukës dhe byrektoret;
 - (b) kafeteritë, bastoret dhe lokalet e vogla të ushqimit të shpejtë;
 - (c) shitoret ushqimore dhe bodrumet e pijeve;
 - (d) bankat;
 - (e) sallonet e sanitarisë, sallonet e mëdha të mobilieve;
 - (f) qendrat sportive dhe të fitnesit;
 - (g) veprimtaritë zejtare më të rënda, si auto ngjyrosësit dhe xhamprerësit;
 - (h) spitalet, poliklinikat, ambulancat specialistike dhe ambulancat stomatologjike me mbi dy karrige;
 - (i) bujtinat;
 - (j) pompat e benzinës; dhe
 - (k) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë;
- (4) **K-4** — nënkategoria e katërt, përfshinë subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të lartë të shërbimit, si për shembull:
- (a) shitoret e mëdha;
 - (b) restorantet, përfshirë gjellëtoret, qebaporet dhe lokalet e ushqimit të shpejtë;
 - (c) klubet e natës;
 - (d) veprimtaritë hoteliere;
 - (e) pompat e benzinës me restorant; dhe
 - (f) veprimtari tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë; dhe
- (5) **K-5** — nënkategoria e pestë, përfshinë subjektet komerciale e industriale të shërbyera me kontratë të veçantë; dhe
- (C) **I** — kategoria e klientëve institucionalë, që shërbehen me kontratë të veçantë dhe ndahen në nënkategori:

- (1) **I-1** — nënkategoria e institucioneve komunale, përfshinë institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme, qendrat kryesore të mjekësisë familjare, bashkësitë lokale, zyrat e vendit, objektet e komunës, teatrot dhe kinematë komunale, objektet kulturore, objektet sportive, zjarrfikësit dhe bashkësitë fetare; dhe
 - (2) **I-2** — nënkategoria e institucioneve qendrore dhe ndërkombëtare, përfshinë institucionet e nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor, policinë, ndërmarrjet publike, postën, gjykatat, prokurorinë, agjencitë e pavarura, qendrat për punë sociale, zyrat e tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësitë diplomatike e konsullore dhe përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare.
- 8.2 Gjeneruesit e nënkategorive K-5, I-1 dhe I-2 shërbejnë me kontejnerë 1,1 ose 7 metër kub. Gjeneruesit duhet të kenë hapësirë brenda premisave të tyre për të vendosë kontejnerët.

Neni 9

Caktimi dhe arkëtimi i tarifave

- 9.1 Kuvendi Komunal cakton tarifat e shërbimit për secilën kategori, duke marrë parasysh ndikimin e tarifave në mjedisin jetësor dhe rekomandimin e Sektorit dhe operatorëve.
- 9.2 Sektori cakton mënyrën e arkëtimin të tarifave.
- 9.3 Kuvendi Komunal mund të vendosë që tarifat t'i arkëtoj vetë si taksë komunale, sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal, nr. 03/L-049, GZRK 27/2008, neni 13.1.
- 9.4 Sektori e rishikon lartësinë e tarifave të paktën çdo tri vjet, duke llogaritur koston e shërbimeve dhe i rekomandon Kuvendit Komunal ndryshimet që i shoh të arsyeshme. Sektori ia përcjell për dijeni rekomandimet e veta Kryetarit të Komunës dhe operatorëve.

Neni 10

Lartësia e tarifave

- 10.1 Kuvendi komunal do të përcaktoj lartësinë e tarifave sipas kategorive të lartëcekura, në bazë të Rregullores për tarifa, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale (vazhdon me çmimet aktuale).
- 10.2 Tarifat faturohen çdo muaj dhe faturat u dorëzohen gjeneruesve deri në ditën e 10 të muajit vijues.
- 10.3 Komuna do ta përcaktoj tarifën për mbeturinat e ndërtim-rrënimit me akt të posaçëm.

Neni 11

Parapaguesit dhe banorët jo rezident

- 11.1 Gjeneruesit mund të parapagujnë tarifat për gjashtë muaj ose një vit.
- 11.2 Gjeneruesit, banorët jo rezident janë gjenerues të kategorisë A që nuk janë banorë të përhershëm të Komunës. Ata pagujnë $\frac{1}{4}$ e tarifës vjetore. Por duhet të dëshmojnë se nuk janë banorë të përhershëm. Dëshmitë përfshijnë:

- (A) faturën e energjisë elektrike që tregon se nuk konsumojnë rrymë në pjesën më të madhe të vitit; dhe
- (B) dokumentet tjera që i përcakton Sektori.

Neni 12 **Kufizime**

12.1 Ndalohet:

- (A) Hedhja e mbeturinave në hapësira jashtë shportave, kontejnerëve, pikave ose qendrave grumbulluese ose lokacioneve të përcaktuara për grumbullim ose deponim;
- (B) Hedhja e mbeturinave të përziera ose të llojit tjetër në shporta ose kontejnerë të përcaktuar për mbeturina të një lloji;
- (C) Hedhja ose djegia e mbeturinave në rrugë, hapësira publike, hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve kolektive ose në prona private;
- (D) Hedhja në kontejnerë publikë e mbeturinave të çfarëdo lloji, pos mbeturinave komunale dhe komerciale;
- (E) Hedhja e mbeturinave në sipërfaqe ujore, përfshirë lumenjtë, liqenet, rrjedhat ujore, përrenjtë dhe sipërfaqet e tjera ose pranë tyre;
- (F) Të zhvendosen shportat, kontejnerët ose pikat grumbulluese pa autorizimin e Komunës;
- (G) Djegia e mbeturinave në pika grumbulluese;
- (H) Nxjerrja, shpërndarja ose përdorimi i mbeturinave nga pikat grumbulluese si ushqim për kafshët;
- (I) Derdhja ose rrjedhja e mbeturinave gjatë bartjes së tyre.

12.2 Kushdo që bartë mbeturina, duhet të marrë masa për të penguar derdhjen ose rrjedhjen e mbeturinave.

12.3 Askush nuk mund të ndryshoj mënyrën, metodat, teknikën ose teknologjinë e largimit të mbeturinave, që përcaktohet me kontratë ose vendim të autoriteteve komunale.

Neni 13 **Mbikëqyrja dhe inspektimi**

13.1 Mbikëqyrin zbatimin e kësaj rregulloreje:

- (A) Komisioni Vëzhgues;
- (B) Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe
- (C) Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencave;

13.2 Inspektojnë zbatimin e Ligjit për mbeturina dhe të kësaj rregulloreje:

- (A) Inspektorati komunal;
- (B) Zyrtarët tjerë të autorizuar të Komunës dhe

(C) Policia e Kosovës.

13.3 Inspektimi bëhet sipas Ligjit për mbeturina, nenet 61–69.

Neni 14 **Komisioni Vëzhgues**

14.1 Komisioni Vëzhgues është trup mbikëqyrës dhe këshillues i përbërë nga tre deri në pesë anëtarë.

14.2 Komisioni Vëzhgues ka për detyrë:

- (A) të vëzhgoj shërbimet e ofruara nga operatorët;
- (B) të promovoj rregullat e hedhjes së mbeturinave të përcaktuara nga Komuna;
- (C) të pranoj sugjerime ose ankesa nga gjeneruesit dhe t'ia paraqesë ato Sektorit; dhe
- (D) t'i raportoj Sektorit në fillim të çdo muaji ose sipas kërkesës së Sektorit.

14.3 Anëtarët e komisionit i emëron Kuvendi Komunal nga radhët e qytetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Kryetari i Komunës dhe grupet më të mëdha të anëtarëve të Kuvendit propozojnë nga një anëtarë.

14.4 Anëtarët e komisionit, shërbejnë për një mandat një vjeçarë ose deri kur t'u filloj mandati anëtarëve të rinj. Anëtarët mund të riemërohen një herë.

Neni 15 **Përmbartimi dhe kushtëzimi i shërbimeve**

15.1 Komuna mund të inicoj procedura përmbartimore dhe gjyqësore ndaj gjeneruesve që nuk paguajnë tarifën e shërbimit.

15.2 Gjeneruesve që nuk i kanë të paguara gjashtë faturat e taksës, Sektori mund t'ua ndaloj shërbimet nga këto drejtori komunale:

- (A) Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- (B) Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave;
- (C) Zyra e Prokurimit;
- (D) Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave;

15.3 Nëse i ndalohen shërbimet sipas këtij neni, gjeneruesi ka të drejtë t'i ankohet Komisionit të Ankesave të Komunës.

Neni 16 **Masat Ndëshkimore**

16.1 Inspektori Komunal, mund të bëj kallëzim penal për shkelje të Ligjit për mbeturina që përbëjnë vepër penale.

16.2 Inspektori Komunal, duhet të shqiptoj gjobë për shkelje lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

- 16.3 Kushdo që nuk njofton Sektorin kur gjeneron mbeturina të ndërtim-rrënit, gjobitet me 100 euro.
- 16.4 Kushdo që kryen veprimet e ndaluara sipas nenit Neni 12 gjobitet me 50 deri në 100 euro, përveç nëse përcaktohet ndryshe me:
- (A) Ligjit për mbeturina, nenet 71–75;
 - (B) Udhëzimin administrativ i MMPH-së, nr. 06/2018, për ndëshkime me gjoba mandatore, botuar në GZRK më 7 nëntor 2018, neni 16, dhe përfshi në këtë rregullore si shtojcë; ose
 - (C) ndonjë tjetër ligj ose akt nënligjor të MMPH-së.

Neni 17

Kësaj rregullore i bashkëngjitet shtojca për gjoba mandatore.

Neni 18

Dispozita përfundimtare

- 18.1 Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas ditës pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunë, respektivisht pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- 18.2 Brenda shtatë ditësh pas ditës që miratohet kjo rregullore, Komuna njofton:
- (A) Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe
 - (B) Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli



SHTOJCË

(Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nr. 06/2018, për ndëshkime me gjoba mandatore, botuar në GZRK më 7 nëntor 2018, neni 16)

1. Veprimet ndëshkuese me gjobë mandatorë dhe vlera e gjobës për personin:

1.1. Me gjobë në vlerë prej 20 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

1.1.1. hedhë cigare në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.1.2. hedhja e çamçakëzit në rrugë ose në sipërfaqe publike.

1.2. Me gjobë në vlerë prej 30 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

1.2.1. hedhë ambalazh dhe mbeturina letre në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.2.2. hedhë ambalazh dhe mbeturina plastike në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.2.3. hedhë ambalazh dhe mbeturina qelqi në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.2.4. hedhë kanaçe në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.2.5. hedhë mbeturina ushqimore në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.2.6. si kalimtar rasti hedhë çfarëdo lloj mbeturine në rrugë ose në sipërfaqe publike.

1.3. Me gjobë në vlerë prej 40 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

1.3.1. hedhë mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale;

1.3.2. hulumton nëpër kontejner të mbeturinave, merr ose shkapërderdh-hedhë mbeturina prej kontejnerit jashtë;

1.3.3. hedhë mbeturina të përziera në kontejnerët ku janë të klasifikuara mbeturinat si: organike, qelqi, letra, plastika, metali, etj.

1.3.4. mbeturinat nga copëtimi i drunjëve i lenë në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.3.5. mbeturinat nga thëngjilli i len në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.3.6. nuk e pastron jashtëqitjen e kafshës së tyre në rrugë, trotuare, parkingje, objekte të banimit kolektiv dhe objekte tjera publike.

1.4. Me gjobë në vlerë prej 50 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

1.4.1. hedhë cigare në rrugë nga automjeti në lëvizje;

1.4.2. hedhë ambalazh dhe mbeturina letre në rrugë nga automjeti në lëvizje;

1.4.3. hedhë ambalazh dhe mbeturina plastike në rrugë nga automjeti në lëvizje;

1.4.4. hedhë ambalazh dhe mbeturinë qelqi në rrugë nga automjeti në lëvizje;

1.4.5. hedhë kanaçe në rrugë nga automjeti në lëvizje;

1.4.6. hedhë mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti në lëvizje;

1.4.7. dëmton kontejnerët për mbeturina komunale

- 1.4.8. i ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina komunale;
- 1.4.9. hedhë akumulatorë në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.10. hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.11. hedhë mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët për mbeturina komunale, rrugë, në natyrë dhe sipërfaqe publike;
- 1.4.12. hedhë ambalazh dhe mbeturina letre në natyrë;
- 1.4.13. hedhë ambalazh dhe mbeturina Plastike në natyrë;
- 1.4.14. hedhë ambalazh dhe mbeturina qelqi në natyrë;
- 1.4.15. hedhë kanaçe në natyrë;
- 1.4.16. hedhë mbeturina ushqimore në natyrë.
- 1.4.17. hedhë mbeturina nga kopshtet në kontejnerët për mbeturina komunale.
- 1.5. Me gjobë në vlerë prej 70 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
 - 1.5.1. hedhë çfarëdo lloj mbeturine nga ballkoni ose dritarja e objektit;
 - 1.5.2. hedhë mbeturina në pusetat për kanalizim;
 - 1.5.3. hedhë mbeturina nga ambalazha e materialit ndërtimor jashtë kontejnerëve (ambalazh letre, metali, plastike dhe materiale të ndryshme).
 - 1.5.4. hedhë mbeturina të ngjyrave në kanalizim;
 - 1.5.5. hedhë mbeturina të ngjyrave në kontejner për mbeturina komunale;
 - 1.5.6. hedhë mbeturina të vajit në tokë nga pakujdesia;
 - 1.5.7. hedhë mbeturinat medicinale në kontejner për mbeturina komunale;
 - 1.5.8. hedhë mbeturina të stallave në afërsi të rrugës brenda vendbanimit (nuk nënkupton shpërndarjen e plehut në ara);
 - 1.5.9. hedhë mbeturina në pronën e tjetrit;
 - 1.5.10. hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në sipërfaqe publike ose në natyrë;
 - 1.5.11. hedhë bateri ose akumulator në sipërfaqe publike ose në natyrë;
 - 1.5.12. hedhë cigaren e ndezur në kontejnerin për mbeturina komunale;
 - 1.5.13. hedhë hirin e nxehtë në kontejnerin për mbeturina komunale.
- 1.6. Me gjobë në vlerë prej 90 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
 - 1.6.1. hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore jashtë vendeve ose kontejnerëve të caktuar nga autoriteti komunal për mbeturina të materialeve ndërtimore;
 - 1.6.2. hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore në kontejnerët për mbeturina komunale;

- 1.6.3. hedhë mbeturina medicinale në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.4. hedhë mbeturina medicinale jashtë kontejnerëve për këto lloje të mbeturinave;
- 1.6.5. hedhë mbetu të vëllimshme në kontejner për mbetur komunale, sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.6. hedhë lloj tjetër të mbeturinave në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.7. hedhë mbeturina të përziera me vaj në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.8. mbeturinat drunore nga krasitja e bimëve ose drunjve nuk i mbledh nga rruga ose hapësira publike në kohën e krasitjes;
- 1.6.9. hedhë mbetu drunore nga krasitja e bimëve ose drunjve në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.10. djegë mbeturina komunale në kontejner.
- 1.7. Me gjorbë në vlerë prej 100 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
 - 1.7.1. hedhë çfarëdo lloj mbet. në ujëra të përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
 - 1.7.2. hedhë çfarëdo lloj mbet. në brigjet e përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
 - 1.7.3. hedhë mbeturina të vajit në sipërfaqe publike, kanalizim, në rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.4. hedhë mbeturina të përziera me vaj në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.5. hedhë mbeturina të gomës dhe goma të automjeteve në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.6. djegë mbeturina komunale në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.7. djegë goma, mbeturi tjera prej gome, në hapës. private, publike, rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.8. djegë mbeturina të ndryshme prej plastike, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.9. djegë mbeturina të ndryshme prej letre në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.10. djegë vajra, mbeturina të vajrave në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
 - 1.7.11. derdh çfarëdo materiali në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë me ç'rast prej saj.